



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 26.04.2024

Projekt-Vendim

“MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BASHKISË MALIQ DHE KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË PËR MOSHËN E TRETË.”

Në mbështetje të ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Bashkia Maliq në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë do të zhvillojë një sërë aktivitete në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për projektin e përbashkët “Një kafe me gjyshin”

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të qarkut Korçë, “Një kafe me gjyshin”
2. Të miratojë përdorimin e fondit 472 635 lekë të deleguar nga Këshilli i Qarkut në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe projektit “Një kafe me gjyshin” si më poshtë :

➤ Miratim fondi për “paga dhe sigurime”, për një punonjës, me 8 orë pune në ditë (kujdestar salle).

Nr .	Emertimi	Vlera
1	Paga (kujdestar salle , 8 orë pune/ditë)	405000
2	Kontribute sigurimi shëndetësor dhe shoqëror	67635
		472635

3. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë .

Konceptoi: Përgj. I Sekt. Sh. të kujdesit
Shoqëror

(Emër Mbiemër)
E. Petriti

Nënshkrimi

Data
Dt 26.04.2024

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu